



# INTESA SANPAOLO BANK

*Drejt të ardhmes me ju.*

Ju dëgjojmë  
**100%**

**“Çmimi Universitar për Kënaqësinë e Klientit”** ishte projekti i fundit i Customer Satisfaction Unit që nisi në Tetor 2010 dhe u zhvillua përgjatë 8 muajve duke u finalizuar me Shpërndarjen e Çmimeve ditën e Enjte dt. 5 Maj 2011.

Objektivat kryesore të projektit ishin të hapë një korridor midis universiteteve dhe Divizionit Ndërkombëtar të Bankave Filiale në mënyrë që të gjenerojë përmirësime e plane të reja për zhvillimin e nevojave të Customer Satisfaction, të rrisë potencialin e punës së kësaj Njësie, të lëshojë rrënjët e mendjeve të talentuara që mund të jenë punonjës potencialë në të ardhmen, duke bërë të mundur një eksperiencë ndërkombëtare unike në fushën e kënaqësisë së klientit në brendësi të një mjedisi akademik. Ky ishte një projekt konkret për kënaqësinë e klientit, që u dha studentëve një mundësi të madhe për të ardhmen, duke u krijuar kushtet për të kaluar nga librat e shkollës në një situatë reale.



Rezultatet e Projektit janë stabilizimi i një platforme efektive dhe i një partneriteti produktiv midis bankës dhe universiteteve lokale. Ky konkurs u zhvillua si rezultat i një bashkëpunimi të ngushtë të Fakulteteve Ekonomike të Universitetit të Tiranës, Universitetit Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, Universitetit “Fan Noli” të Korçës me Intesa Sanpaolo Bank Albania. Morrën pjesë shumë studentë midis të cilëve u përzgjedhën 12. Ata u organizuan në skuadra me nga dy pjesëmarrës dhe ideuan, hartuan e krijuan projekte konkrete për kënaqësinë e klientit, të cilat do i vënë në jetë në një ambient të vërtetë pune duke mundur të fitojnë një experiencë të shkëlqyer ndërkombëtare.

Një komision i veçantë vlerësoi projektet duke shpallur dy projektet më të mira në fushën e kënaqësisë së klientit: në kategorinë e “Inovacionit”, Znj. Nermin Gjyzezi dhe Znj. Riselda Dani dhe në kategorinë e “Zbatimit” Znj. Aurora Guma e Znj. Sabina Buza. Të gjithë studentët e përzgjedhur do kenë mundësinë e një internshipi pranë Intesa Sanpaolo Bank Albania për të vënë në jetë projektet e tyre duke i shndërruar idetë e propozuara në realitet. Gjatë ceremonisë së Dhënies së Çmimeve u bë një prezantim i plotë i projektit në rang ndërkombëtar e kombëtar si dhe prezantime të shkurtra të projekteve të realizuara nga studentët.

Në ceremoninë e dhënies së Çmimeve ishte pjesëmarrës Drejtori i Bankës tonë Z. Stefano Farabbi, Drejtori i Divizionit të Shitjeve, Z. Alberto Prestopino, koleget italiane, Barbara Carniti, përfaqësuese e Zyrës së Burimeve Njerëzore pranë Divizionit Ndërkombëtar të Bankave Filiale, Federica Mele, inicuese e projektit në shkallë ndërkombëtare, Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, Znj. Entela Zigori, Drejtoresha e Departamentit të Komunikimit, Znj. Lauresha Basha si dhe të gjithë studentët pjesëmarrës. U shpërndanë Çertifikatat e Pjesëmarrjes dhe Çertifikatat e Fituesve shoqëruar me disa dhurata të vogla simbolike për t’i ruajtur si kujtim nga ky event. Ky ishte projekti i parë i këtij lloji dhe sukcesi i tij do na çojë drejt përsëritjes së përvitshme të bashkëpunimeve të ngjashme me Universitetet në Shqipëri.

